

KËRKESË
Nr. 1325/10, datë 4.6.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij afishimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 (objektet), për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre (lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë etj.), të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Pretendim pronësie”, sqarojmë se personat që pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim”, sqarojmë se do të merret konfirmim pranë ZVRPP-së respektive. Në bazë të të dhënave përfundimtare që do të jepen do të hartohet dhe lista që do të shoqërojë projektvendimin për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, sqarojmë se personat të cilët pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë pranë ZVRPP-së për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për objektet për të cilat është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, sqarojmë se nuk ka informacion zyrtar nga ZVRPP-ja apo ALUIZNI. Personat që pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin pranë zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ose të paraqesin vetëdeklarimin nëse janë në proces legalizimi, si dhe të paraqesin dokumentacionin tekniko-ligjor.

Për objektet për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim”, do të rikërkohet konfirmim pranë ZVRPP-së. Për objektin për të cilin është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor pranë MPPT-së ose ARSH-së.

Vlera totale e shpronësimit është 127 130 183 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

